

SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-177/2015

Prishtinë,  
29 nëntor 2017

Në çështjen juridike të:

**M. D.**

Përfaqësuar nga:

**I. O.** (avokat)

**Pala ankuese**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014 të datës 30 prill 2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA21378), pas shqyrtimit të mbajtur më 29 nëntor 2017, mori këtë

**AKTGJYKIM**

Ankesa e M. D. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014 përkitazi me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA21378 hidhet poshtë si e paafatshme.

**Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike**

1. Më 20 prill 2007, M. D. (më tutje: pala ankuese) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (më tutje: AKP) duke kërkuar ri-posedimin mbi ngastrën kadastrale nr.872, kullosë me sipërfaqe prej 0.22.12 ha dhe ngastrën kadastrale nr.873, pyll me sipërfaqe prej 01.57.68 ha, të dy ngastrat ndodhen në fshatin “Drsnik”, në Komunën e Klinës (më tutje: pronat e kërkuara).
2. Pala ankuese deklaroi se ajo ishte pronarja e vetme e pasurisë të cilën e kishte fituar në bazë të Vendimit të Komunës së Klinës. Sipas palës ankuese, pronat e kërkuara janë të uzurpuara nga një person i panjohur. Humbja e posedimit mbi pronën kishte ndodhur si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 që ndodhën në Kosovë.
3. Për ta mbështetur Kërkesën e saj, pala ankuese në AKP i dorëzoi këto dokumente:
  - Vendimin nr.04-463-54/92-2, e lëshuar nga Kuvendi Komunal i Klinës, Departamenti për Urbanizëm, Banim, Komunal dhe Çështje të Pronave të Paluajtshme më 5 mars 1997 me të cilin:
    - Ishte aprovuar kërkesa e palës ankuese dhe ishte anuluar Aktvendimi nr. 215 i lëshuar nga Komisioni i dytë Komunal për Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronësore që burojnë nga uzurpimi arbitrar i tokës shoqërore të datës 1 dhjetor 1963,
    - Ishte vërtetuar se pala ankuese ishte pronare e ngastrës kadastrale nr.873, kullosë me sipërfaqe prej 0.22.12 ha dhe e ngastrës kadastrale nr.872; pyll me sipërfaqe prej 1.57.68 ha. Vendimi u bë i formës së prerë më 8 prill 1997.
4. Njoftimi i kërkesës u bë më 21 qershor 2010 duke e publikuar atë në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së nr.2 dhe në Listën për Prona të Zyrës së UNHCR-së. Gazeta dhe lista u lanë te prijësi i fshatit i cili pranoi që t’ua vë ato në dispozicion palëve të interesuara. Publikimet e njëjta u lanë në Komunën e Klinës, Zyrën Kadastrale dhe Gjykatën Komunale të Klinës, Zyrën Rajonale të AKP-së në Pejë. Përveç kësaj, Lista dhe Gazeta u shpërndanë te UNHCR-ja, Ombudspersoni, DRC-ja, Agjencia Kosovare e Privatizimit, etj.
5. Vendimi Nr.04-463-54/92-2 nuk u gjet as te institucionet kompetente në Kosovë e as te organet e zhvendosura. Sa i përket pronave të kërkuara, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e ka gjetur ngastrën kadastrale nr.872 të ndarë në dy nën-ngastra. Ngastra nr. 872/1, pyll me sipërfaqe prej 00.93.74 ha, e regjistruar në emër të Z. D.; ngastra nr.872/2, pyll me sipërfaqe prej 00.93.94 ha, e regjistruar në emër të T. D. dhe ngastra nr.873, e regjistruar në emër të T. D.
6. Pala ankuese deklaroi se ajo nuk ishte në dijeni se pronat e kërkuara ishin regjistruar në emër të kunatës dhe vajzës së burrit të saj; pasi ajo mori këtë informacion ajo deklaroi se ajo nuk ka interes për kërkesën (faqe nr. 055 dhe faqja 056 të shkresave të lëndës)

7. Më 30 prill 2014, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/236/2014 e refuzoi kërkesën e palës ankuese me arsyetimin se ajo nuk ka arritur të dëshmojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-1999.
8. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 24 nëntor 2014, ndërsa ajo paraqiti ankesë më 14 janar 2015.

### **Pretendimet e palës ankuese**

9. Pala ankuese e kundërshtoi vendimin e KKPK-së për shkak të shkeljes substanciale të dispozitave të Ligjit për AKP-në, shkeljes së Ligjit mbi Pronësinë, shkeljes së Konventave Evropiane për Çështjet Pronësore, për shkak të përcaktimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.
10. Sipas palës ankuese, AKP-ja e mori vendimin e saj pa analizuar dhe shqyrtuar provat e bashkangjitura në kërkesë, sepse pala ankuese është pronare e pronave të kërkuara duke u bazuar në Vendimin Nr.04-463-54/92-2, i cili u bë i formës së prerë më 8 Prill 1997. Në bazë të vendimit të përmendur, Drejtoria për Kadastër është autorizuar për t'i kryer ndryshimet në Kadastër; kjo do të thotë që nëse autoriteti kompetent nuk ka arritur t'i kryejë detyrat e veta, kjo nuk mund të ndikojë në të drejtat e palës ankuese mbi pronat e kërkuara.
11. Në fund, pala ankues kërkon që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë ankesën e saj si të bazuar dhe ta njoh atë si pronare të pronave të kërkuara.

### **Arsyetimi ligjor**

12. Ankesa është e paafatshme.
13. Neni 12.1 i Ligjit nr.03/L-079 parasheh si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit rreth Kërkesës, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.*
14. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 24 nëntor 2014. Kështu që afati kohor për të paraqitur ankesë ka kaluar më 24 dhjetor 2014. Megjithatë, pala ankuese e paraqiti ankesën e saj më 14 janar 2015. Kjo është jashtë afatit kohor.
15. Gjykata konstatoi se dorëzimi ishte bërë personalisht në pajtim me nenin 110.1 të Ligjit nr. 03 / L-006 për Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.

38/2008). Pala ankuese nuk ofroi ndonjë arsye për vonesën në paraqitjen e ankesës dhe as Gjykata nuk arriti të gjejë ndonjë arsye për vonesë në shkresat e lëndës.

16. Rrjedhimisht, ankesa duhet të hedhet poshtë mbi baza procedurale si të paafatshme në pajtim me nenin 13.3 nën-paragrafi (b) të Ligjit Nr. 03 / L-079 dhe Nenit 195.1 (a) dhe 196 të Ligjit Nr. 03 / L-006.

### **Këshille ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

*Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit*

*Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it*

*Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar*

*Timo Eljas Torkko, Ushtues Detyre i Referentit të EULEX-it*